



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 11 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për gjuhën e punës

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Huper

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit kujdestar të
Rexhep Selimit
Robert Karls

Mbrojtësit të Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 20 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 8(3)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhe 6 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, gjatë seancës së paraqitjes së parë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht, “të akuzuarit”), kërkoi nga palët që të paraqesin me gojë parashtrimet e tyre përkatëse, në lidhje me miratimin e gjuhës së punës për procesin aktual (të quajtur bashkërisht “Urdhra për parashtrime”).²

2. Më 9, 10, dhe 11 nëntor 2020, u mbajt paraqitja e parë e të katër të akuzuarve.³ ZSP-ja parashtrroi se anglishtja duhet të jetë gjuha e punës në procesin numër KSC-BC-2020-06.⁴ Gjithashtu, secili nga ekipet e mbrojtjes parashtruan se anglishtja duhet të jetë gjuha e punës në proceset aktuale.⁵

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështje të ndërlidhura* (“Urdhri i parë për parashtrime”), 5 nëntor 2020, publik, para. 21(a) dhe (c); F00057, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështje të ndërlidhura* (“Urdhri i dytë për parashtrime”), 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a) dhe (c); F00060, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështje të ndërlidhura* (“Urdhri i tretë për parashtrime”), 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a) dhe (c); F00061, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështje të ndërlidhura* (“Urdhri i katërt për parashtrime”), 6 nëntor 2020, publik, para. 20(a) dhe (c).

³ KSC-BC-2020-06, Version pune i transkriptit, 9 nëntor 2020 (“9 nëntor 2020 Version pune i transkriptit”); Version pune i transkriptit, 10 nëntor 2020 (“10 nëntor 2020 Version pune i transkriptit”); Version pune i transkriptit, 11 nëntor 2020 (“11 nëntor 2020 Version pune i transkriptit”).

⁴ 9 nëntor 2020 Version pune i transkriptit, f. 18, rreshti 16-20, f. 38, rreshtat 16-17; 10 nëntor Version pune i transkriptit, f. 68, rreshtat 23-24; 11 nëntor 2020 Version pune i transkriptit, f. 93, rreshtat 1-2.

⁵ 9 nëntor 2020 Version pune i transkriptit, f. 18, rreshtat 23-24, f. 38, rreshtat 16-21; 10 nëntor Version pune i transkriptit, f. 68, rreshti 23 deri në f. 69, rreshti 3; 11 nëntor 2020 Version pune i transkriptit, f. 93, rreshtat 5-6.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Në përputhje me nenin 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të DHS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja, dhe, në çdo proces gjyqësor, një panel cakton gjuhët e punës në ato procese, siç është e përshtatshme dhe duke respektuar në tërësi të drejtat e të akuzuarve.

4. Në përputhje me rregullën 8(3)(a) të Rregullores, në varësi të nenit 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi t'i ketë dëgjuar palët, dhe kur është e përshtatshme, mbrojtësin e viktimave, paneli vendos se cila ose cilat gjuhë të punës do të përdoren gjatë procesit.

III. DISKUTIM

A. PËRCAKTIMI I GJUHËS SË PUNËS

5. Neni 20 i Ligjit e lejon gjykatësin e procedurës paraprake që të miratojë vendim për gjuhët e punës në cilëndo "procedim". Siç është bërë e ditur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në KSC-BC-2020-05, derisa as Ligji e as Rregullorja nuk e përkufizojnë "procedimin", termi përkufizohet si "çështje juridike në shqyrtim para një Dhome"⁶. Duke pasur parasysh paraqitjet e para të të akuzuarve, dhe në pajtim me të drejtat e tyre sipas nenit 21 të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të nevojshme që të përcaktojë gjuhën e punës në procedimin aktual.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00032, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për gjuhën e punës ("Vendim për gjuhën e punës në çështjen Mustafa")*, 8 tetor 2020, publik, para. 10, citim nga ICC/GJNP-së, *Situation in the Democratic Republic of the Congo*, ICC-01/04-556, Appeals Chamber *Gjendja në Republikën Demokratike të Kongos*, ICC-01/04-556, Dhoma e Apelit, [*Judgment on victim participation in the investigation stage of the proceedings in the appeal of the OPCD against the decision of Pre-Trial Chamber I of 7 December 2007 and in the appeals of the OPCD and the Prosecutor against the decision of Pre-Trial Chamber I of 24 December 2007*](#), 19 dhjetor 2008, para. 45.

6. Siç është bërë e ditur në Urdhrat për parashtrime, përcaktimi i gjuhës së punës është i domosdoshëm për të siguruar kryerje të drejtë, efikase dhe të shpejtë të procedimit.⁷ Veçanërisht, kjo do të mundësojë përgatitjen dhe organizimin e parashtrimeve të një pale apo pjesëmarrësi. Gjithashtu, kjo do të shtojë parashikueshmërinë dhe kapacitetin për planifikim të njërive të përkthimit brenda Zyrës Administrative dhe ZSP-së.⁸

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se gjuha e procedimit deri tani ka qenë anglishtja, dhe të gjitha parashtrimet nga ZSP-ja, Zyra Administrative, dhe Mbrojtësit, si dhe të gjitha vendimet dhe urdhrat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake janë lëshuar në anglishte. Për më tepër, të gjitha palët janë pajtuar që anglishtja të jetë gjuhë e punës.⁹

8. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton që, për procesin KSC-BC-2020-06, gjuha e punës të jetë anglishtja. Për këtë arsye, palët dhe pjesëmarrësit, do t'i paraqesin parashtrimet e tyre në anglishte. Nëse shtojcat, materiali mbështetës apo provat tjera në të cilat mbështeten palët dhe pjesëmarrësit, në tërësi apo pjesërisht, janë në gjuhë të ndryshme nga anglishtja, duhet të bëhet përkthimi i këtyre materialeve në anglishte. Ky vendim nuk është i formës së prerë në lidhje me obligimet për përkthim sipas Ligjit dhe Rregullores.

B. ZBATIMI PRAKTIK

⁷ Urdhri i parë për parashtrime, para. 16; Urdhri i dytë për parashtrime, para. 16; Urdhri i tretë për parashtrime, para. 16; Urdhri i katërt për parashtrime, para. 16.

⁸ *Vendim për gjuhën e punës në çështjen Mustafa*, para. 11.

⁹ 9 nëntor 2020 Version pune i transkriptit, f. 18, rreshtat 16-20 dhe 23-24, f. 38, rreshtat 16-21; 10 nëntor Version pune i transkriptit, f. 68, rreshti 23 to f. 69, rreshti 3; 11 nëntor 2020 Version pune i transkriptit, f. 93, rreshtat 1-2 dhe 5-6.

9. Për zbatimin praktik të përcaktimit të lartpërmendur, palëve dhe pjesëmarrësve u jepen udhëzimet e mëposhtme, sipas rrethanave. Udhëzimet janë organizuar në dy faza kur përkthimi nevojitet:

- (1) *Rregull i përgjithshëm*: udhëzimet para paraqitjes së parashtrimeve, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës ose provat; dhe
- (2) *Përjashtimet*: udhëzimet pas paraqitjes së parashtrimeve, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës ose provat.

Në fund, përshkruhet procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me përkthimet.

1. Udhëzime për fazën para paraqitjes së parashtrimit

10. Palët dhe pjesëmarrësit kanë obligim që, në parim të veprojnë në përputhje me udhëzimet në vijim *para* paraqitjes së çfarëdo parashtrimi, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës apo provat e tjera.

11. Parashtrimet duhet të paraqiten në anglishte. Kur pjesë të tekstit, qoftë në pjesën kryesore të tekstit apo në shënimet në fund të faqes, janë në gjuhë tjetër nga anglishtja, duhet të jepet përkthimi në anglishte i këtyre.

12. I njëjti kriter gjuhësor vlen për shtojcat, materialin mbështetës ose provat e tjera të paraqitura në të cilat mbështetet pala ose pjesëmarrësi. Kjo vlen për materialin e krijuar nga pala ose pjesëmarrësi, ose të mbledhur nga burime tjera. Për të mbajtur në dokumentacionin e procesit vetëm materialet me rëndësi, nuk është e nevojshme që të paraqiten materialet e plota nëse pala apo pjesëmarrësi mbështetet vetëm në disa pjesë të tyre. Në rastet kur një dokument nuk mund të ndahet dhe pala ose pjesëmarrësi mbështetet vetëm në pjesë të caktuara të tij, duhet të shënohet pjesa, faqja, paragrafi ose fjalia në të cilën pala ose pjesëmarrësi mbështetet dhe duhet tu jepet përkthimi në anglishte i pjesës në fjalë.

13. Sa i përket çfarëdo parashtrimi, përfshirë shtojcat, dhe materialin mbështetës të paraqitur nga individë, autoritetet kosovare, shtetet e treta apo organizata ndërkombëtare, vlejné këto kritere:

- (1) Një parashtrim, përfshirë shtojcat dhe materialin mbështetës i paraqitur nga një individë kosovar ose autoritetet kosovare mund të paraqitet në anglishte, shqipe apo serbishte.
- (2) Një parashtrim, përfshirë shtojcat, dhe materialin mbështetës i paraqitur nga individë nga shtete të treta ose autoritetet a tyre, ose nga një organizatë ndërkombëtare mund të paraqitet në anglisht ose në çdo gjuhë tjetër të zgjedhur ose gjuhë zyrtare.
- (3) Nëse një parashtrim, përfshirë shtojcat, dhe materialin mbështetës i adresohet Panelit, ai shpërndahet nga Zyra Administrative. Është përgjegjësi e Zyrës Administrative që të sigurojë përkthimin në anglishte të çdo parashtrimi të protokolluar, përfshirë të shtojcave, dhe materialit të paraqitur në këtë mënyrë.
- (4) Nëse një parashtrim, përfshirë shtojcat, dhe materiali mbështetës, nga individë, autoritetet kosovare, shtetet e treta apo organizata ndërkombëtare dorëzohet nga ZSP-ja, është përgjegjësi e saj të sigurojë përkthimin e tyre para se t'ia dorëzojë panelit.

14. Në rastin e audio/videomaterialeve dhe materialeve në Internet, palët dhe pjesëmarrësit, sipas rastit, nuk mund të bazohen në atë material pa paraqitur transkriptimin e tij. Për materiale të tilla, duhet të sigurohen këto të dhëna:

- (1) sipas rastit, burimi relevant në Internet, dhe data e koha kur është parë për herë të fundit;
- (2) segmenti i saktë kohor ose fragmenti i tekstit, sipas rastit, në të cilin bazohet pala apo pjesëmarrësi, sipas rastit;

(3) transkripti i fragmentit relevant në gjuhën origjinale, qoftë në parashtrimin kryesor apo shtojcat e tij; dhe

(4) nëse është paraqitur nga një palë apo pjesëmarrës, përkthimi në anglishte i fragmentit të transkriptuar.

15. Në parim, preferohen përkthimet e përgatitura nga përkthyes të kualifikuar, qoftë brenda Njesisë së Përkthimeve ("NJP"), qoftë nga shërbimi gjuhësor i ZSP-së. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës paraprake është i vetëdijshëm se, në raste të caktuara, si në raste urgjente apo kur përkthyesit e kualifikuar nuk janë në dispozicion, mund të pranohen edhe përkthime të tjera.

16. Siç parashikohet në pjesën 4(2) të Udhëzuesit për përkthimet me shkrim dhe me gojë të Zyrës Administrative (KSC-BD-13) ("Udhëzuesi"), përkthimet e ofruara nga NJP-ja do të cilësohen si "version pune", i "vetëredaktuar" ose "zyrtar".

17. Kur përkthimi vjen nga ZSP-ja dhe është përgatitur nga përkthyes të kualifikuar ose nga personeli tjetër i kualifikuar, ai përkthim cilësohet si "Përkthim i ZSP-së". Kur përkthimi është përgatitur nga Mbrojtja, mbrojtësi i viktimave ose ndonjë pjesëmarrës tjetër, do të cilësohet si "Përkthim i Mbrojtjes", "Përkthim i mbrojtësit të viktimave" ose "Përkthimi i [emri i pjesëmarrësit]". Kur përkthimi i dhënë nga një palë ose pjesëmarrës është përgatitur nga të tjerët, si për shembull ndonjë institucion gjyqësor ose përkthyes të jashtëm të pakualifikuar, ai nuk mund të mbajë cilësimet e lartpërmendura, përkundrazi cilësimi i burimeve të jashtme mund të mbahet në dokument ose në materialin në fjalë. Cilësimi i drejtë i përkthimeve (apo mungesa e tyre) mbetet përgjegjësi e palëve dhe pjesëmarrësve. Është nën kompetencën e brendaqenësishme të Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të kërkojë më vonë verifikimin nga NJP-ja, të çdo përkthimi të bërë.

18. Çdo kërkesë për përkthim drejtuar NJP-së bëhet paraprakisht, në kohë të mjaftueshme dhe në pajtim me protokollin ekzistues, për të mundësuar përkthim dhe redaktim të duhur të elementeve të tekstit në fjalë.

19. Megjithëse ZSP-ja ka shërbimin e vet gjuhësor, këshillohet që të koordinohet dhe të bashkëpunojë me NJP-në për çështjet e përkthimit, për të shpejtuar procedurat dhe maksimizuar efikasitetin.

2. Udhëzime për fazën pas paraqitjes së parashtrimeve

20. Nëse një parashtrim i protokolluar, ose pjesë të tij, është paraqitur në një gjuhë tjetër nga anglishtja, atëherë Njësia për Administrimin Gjyqësor ("NJAGJ") kërkon përkthimin e tij përmes sistemit elektronik të administrimit gjyqësor "*Legal Workflow*" ("LWF"), në pajtim me pjesën 5(1)(b) të Udhëzuesit dhe pjesën 2(5) të Udhëzimit të Zyrës Administrative për Kërkesat për Shërbime për Përkthim me Shkrim, e me Gojë dhe Verifikim (KSC-BD-14).

21. Nëse një shtojcë, material mbështetës ose provë tjetër përmban tekst në gjuhë tjetër nga anglishtja, pala ose pjesëmarrësi, sipas rastit, përcakton saktësisht çfarë dhe sa duhet përkthyer, duke saktësuar, sipas rastit, pjesën, faqen, paragrafin ose fjalinë relevante për t'u përkthyer, në LWF, në të njëjtën kohë kur paraqet dokumentin përkatës për protokollim në pajtim me pjesët 5(1)(b), 5(1)(d), dhe 5(3)(a) të Udhëzuesit.

22. Duke pasur parasysh pjesën 5(2) të Udhëzuesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ruan të drejtën të kërkojë nga NJP-ja, përmes NJAGJ-së, që të përkthejë elementë të tekstit që kërkojnë përkthim zyrtar në anglishte në këto situata:

- (1) Në rastin kur pala dhe pjesëmarrësi, sipas rastit, ka ofruar vetëm përkthimin e pacilësuar të elementeve përkatës të tekstit (shih paragrafin 17); ose

(2) Në rastin kur nuk është kërkuar përkthimi i një elementi të tekstit të paraqitur në një gjuhë tjetër nga anglishtja, por të cilin gjykatësi i procedurës paraprake e vlerëson me rëndësi për zgjidhjen e kërkesës ose çështjes.

23. Vendimi i dhënë më lart nuk është i formës së prerë sa i përket obligimit të palës apo pjesëmarrësit për të paraqitur, nga fillimi, përkthimin në anglishte të çdo parashtrimi të protokolluar, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës ose provat e tjera¹⁰ ose, në raste të tjera, të përcaktojnë shtrirjen e përkthimit të nevojshëm me saktësi.¹¹

24. Duke pasqyruar paragrafin 14 më lart, palët dhe pjesëmarrësit, sipas rastit, u sillet në vëmendje të mos paraqesin audiomaterial, videomaterial ose material nga Interneti pa transkriptim përkatës. Në raste kur nuk respektohen këto udhëtime, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka të drejtë që ose:

- (1) të mos marrë parasysh referencat relevante në dokumentet e protokolluara, përfshirë shtojcat, ose materialin mbështetës ose provat; ose
- (2) të kërkojë nga pala ose pjesëmarrësi, sipas rastit, të paraqesë korrigjim të dokumentit të protokolluar, përfshirë shtojcat, ose materialit mbështetës ose provave, përfshirë transkriptimin e referencave relevante dhe përkthimin në anglishte të tyre.

¹⁰ *Shih më lart*, para. 10 dhe 11.

¹¹ *Shih më lart*, para. 21.

3. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me përkthimet

25. Çdo mosmarrëveshje ose kundërshti sa i përket saktësisë së përkthimeve zgjidhet nga NJP-ja.

IV. VENDIM

26. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **PËRCAKTON** që anglishtja është gjuha e punës për procedimin me numër KSC-BC-2020-06;
- b) **URDHËRON** cilëndo palë ose pjesëmarrës, sipas rastit, të paraqesë çdo parashtrim, shtojcë ose material mbështetës ose prova tjera të paraqitura bashkërisht me të parashtrimin në pajtim të plotë me udhëzimet e hollësishme të përcaktuara më lart; dhe
- c) **URDHËRON** NJAGJ-në që të informojë çdo palë ose pjesëmarrës, sipas rastit, për kriteret e përcaktuara më lart, nëse parashtrimi, përfshirë shtojcat, ose material tjetër të paraqitur nuk është në pajtueshmëri me udhëzimet e përcaktuara në këtë vendim.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 11 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë.